



KB

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

18473
Nr. _____ prot.

Vlorë, më 14.09.2026

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____. 2026

PËR

MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA DJEGIA E
BANESËS TË Z.ARBEN METO DHE SHPËRBLIMIN FINANCIAR NGA ANA E
BASHKISË VLORE.

Këshilli i Bashkisë Vlorë në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 2, neni 9/1 pika b, neni 29/1, neni 54 pika dh ,të ligjit nr.45/2019 datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen Civile”, në VKM Nr. 329, data 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” paragrafi III/ë, pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Drejtoria e Financës dhe Këshilli i Qarkut Vlorë,

VENDOSI:

1. Të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e z.Arben Meto, e ndodhur në lagjen “Kushtrimi”, Rajoni Nr5, Bashkia Vlorë, në datën 04.06.2026, sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë përkatësisht në masën:

A. 208,871 (dyqind e tetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e një) lekë për punime ndërtimi.
(417,743x50%).

B. 501,325 (pesëqind e një mijë e treqind e njëzetë e pesë) lekë për mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake.

2. Shpërblimi financiar do të përballohet nga fondi rezervë për Mbrojtjen Civile të Bashkisë Vlorë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financë-Buxhetit dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile pranë Bashkisë Vlorë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015, neni 55 pika 6.

KRYETAR
Brunilda Mersini





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 18473 prot.

Vlorë, më 14.09 2026

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN “MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA DJEGIA NË BANESËN E Z.ARBEN METO DHE SHPËRBLIMI FINANCIAR NGA ANA E BASHKISË VLORË”

Në mbështetje të ligjit nr. 45/2019, “Për Mbrojtjen Civile” si dhe në zbatim të VKM-së nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, është ndjekur procedura për evidentimin, konstatimin dhe vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga zjarri në banesën e z.Arben Meto.

Në datën 08.06.2026, pranë Bashkisë Vlorë është paraqitur kërkesa e shtetasit z.Arben Meto, me nr.11197 prot., lidhur me dëmet e shkaktuara nga zjarri në banesën e tij në datë 04.06.2026 e ndodhur në lagjen “Kushtrimi”, Rajoni Nr.5, Bashkia Vlorë.

Pas administrimit të kërkesës dhe dokumentacionit përkatës, në zbatim të procedurave të përcaktuara në legjislacionin për Mbrojtjen Civile, me Urdhërin e Brendshëm Nr.436 datë 17.03.2026 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, komisioni përkatës ka kryer verifikimin në terren me qëllim evidentimin dhe konstatimin e dëmeve të shkaktuara në banesë.

Nga verifikimi në vend është hartuar procesverbali i konstatimit të gjendjes, datë 01.07.2026, në të cilin janë evidentuar dëmet e shkaktuara në banesë si pasojë e ngjarjes së zjarrit.

Në vijim, me shkresën nr.11197/1 prot., datë 10.08.2026, me objekt “Dërgohet dokumentacioni për banesën e djegur të z.Arben Meto” në Këshillin e Qarkut Vlorë për të vazhduar me preventivat e vlerësimit të dëmeve nga komisioni i ekspertëve me qëllim vijimin e procedurës së vlerësimit financiar.

Në vijim të kësaj procedure, Këshilli i Qarkut Vlorë me shkresën Nr.11197/2 prot, datë 31.08.2026 “Dërgim dokumentacioni për banesën e djegur të z.Arben Meto”, ka përcjellë pranë Bashkisë Vlorë preventivin e hartuar nga komisioni i ekspertëve, në të cilin është përcaktuar vlera financiare e dëmeve të shkaktuara në banesën e z.Arben Meto.

- Vlera totale e dëmeve të vlerësuara në banesë është 710,196 (shtatëqind e dhjetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë.

Në bazë të dokumentacionit të administruar, verifikimit në terren dhe vlerësimit teknik të dëmeve, si dhe në zbatim të ligjit nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile” dhe VKM-së nr.329, datë 15.05.2012, propozohet miratimi i vlerës 710,196 lekë dhe dhënia e ndihmës financiare përkatëse, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Aktualisht Bashkia Vlorë disponon fondet e nevojshme për përballimin e kësaj ndihme, e cila do të financohet nga fondet e parashikuara për Mbrojtjen Civile.

Për sa më sipër, kërkohet miratimi i Këshillit Bashkiak Vlorë për vlerën e dëmit dhe dhënien e ndihmës financiare për z.Arben Meto, në shumën 710,196 lekë.

DREJTOR

Jurian Mina

